

PROBLEMI I PËRKUFIZIMIT TË DIJES
TEMA PËR TITULLIN
MASTER I FILOZOFISË NË DREJTIMIN FILOZOFI
NGA
LIRON KRASNIQI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI FILOZOFI
PRISHTINË

SHTATOR, 2022

EKSPOZE E TEMËS

PROBLEMI I PËRKUFIZIMIT TË DIJES

Mentori: *Prof. Ass. Dr. Kristë SHTUFI*

Tema në punim trajton problemin e dijes në filozofi, duke pasqyruar një vështrim mbi dijen dhe kuptimin e saj. Duke e përdorur metodën e analizës konceptuale kam arritur në përfundime të caktuara të cilat na japin një pasqyrim të përgjithshëm rreth karakteristikave që e sintetizojnë dijen. Orientimi bazë i punimit të diplomës është shpalosja e interpretimeve të dijes që nga Platoni e deri te Gettieri. Nga përkufizimet e shumta mbi dijen kam arritur që t'i shpalos disa nocione mjaft problematike mbi dijen, të cilat i hasim edhe në filozofinë e shumë autorëve të cilët trajtonin problemin e dijes në filozofi. Me anën e analizimit të të gjitha materialeve që kam përdorur në punimin tim të diplomës, kam arritur në disa konkluzione të rëndësishme në lidhje me problemin e dijes në filozofi, e cila përfshin interpretimet që nga Platoni me teorinë e dijes si dhe alegorinë e shpellës. Pas trajtimit të pikave të parapara për tu shtjelluar në këtë punim kam arritur që të vij në disa konkluzione mbi raportin e dijes. Në fund të punimit të diplomës do të arrihet një pasqyrim i përgjithshëm i cili do të na mundësojë njohje sa më të thellë të problemit të përkufizimit të dijes në filozofi, ku do e shohim se teoria e njohjes dhe problemi i dijes në filozofi zënë një vend mjaft të gjerë në përpunimin e problemit të përkufizimit të dijes. Dija presupozon ndarjen e botës në një objekt dhe në një subjekt. Subjekti është hierarki komplekse, themeli i së cilës është e gjithë tërësia shoqërore. Por, krejt në fund prodhuesi përfundimtar i dijes është vetë njeriu.

PËRMBLEDHJE E KAPITUJVE

Punimi përbëhet prej katër kapitujve, ku tendenca kryesore është trajtimi i problemit të përkufizimit të dijes në filozofi. Me anën e analizimit të të gjitha materialeve që kam përdorur në punimin tim të diplomës, kam arritur në disa konkluzione të rëndësishme në lidhje me problemin e dijes në filozofi, e cila përfshin interpretimet që nga Platoni me teorinë e dijes si dhe alegorinë e shpellës. Pas trajtimit të pikave të parapara për tu shtjelluar në këtë punim kam arritur që të vij në disa konkluzione mbi raportin e dijes.

Titulli i kapitullit të parë, është teoria e Platonit për njohjen dhe arritjen e dijes. Elaborimi përqendrohet kryesisht në pikëpamjet e Platonit ku e përkufizon dijen si një besim i vërtetë për një çështje të caktuar. Platoni e fillon njohjen e zakonshme të llojeve të ndryshme të sendeve të natyrës që na shfaqen para nesh. Tek alegoria e shpellës Platoni na kërkon që ne të imagjinojmë disa njerëz që jetojnë në një shpellë të madhe, ku ata që jetojnë aty që nga fëmijëria kanë qenë të lidhur me zingjirë nga këmbët dhe nga qafa, ku në këtë mënyrë ata nuk kanë mundur që të bëjnë asnjë lëvizje, dhe njëri nga ta del nga zingjirët dhe arrin ta shohë botën reale sipas Platonit.

Titulli i kapitullit të dytë, është teoria mbi konstruktimin e dijes, ku e shohim se epistemologjia e studion natyrën e veprimtarisë njerëzore, marrëdhënien e njohurisë me realitetin, kushtet për ekzistencën e saj në sistemin e kulturës dhe komunikimit, dhe mënyrat për të arritur deri te e vërteta. Njohja është gjithmonë në lëvizje, është një kalim nga injoranca në njohuritë e reja, nga ajo pak njohuri në më tepër njohuri. Në veprimtarinë njohëse, koncepti i së vërtetës është qendror. E vërteta është korrespondenca e mendimeve tona me realitetin objektiv. Dija është kuptimi i besueshëm i një çështjeje, pra me aftësinë e përdorimit të tij për një qëllim të caktuar.

Titulli i kapitullit të tretë, është ekzistenca e dijes, ku e shohim dijen e drejtpërdrejtë dhe problemin e dijes, ku për shembull: kur ne e shikojmë Diellin, jemi të vetëdijshëm për shikimin tonë ndaj Diellit; kështu që ‘shikimi i Diellit’ është një objekt, me të cilin kemi njohje të drejtpërdrejtë. Ky lloj i dijes së drejtpërdrejtë, i cili mund të quhet edhe si vetë-vetëdije, është burim i gjithë njohjes sonë të drejtpërdrejtë. Pyetjet “ku e din ti këtë, pse e din ti këtë”, këto pyetje në fakt e kanë zgjeruar kureshtjen për dijen.

Titulli i kapitullit të katërt, është kritika e Edmund L. Gettier ndaj teorisë së Platonit për dijen, ku sipas Gettier-it interpretimet e njohura të Platonit realisht nuk janë edhe të vlefshme, sepse ne duhet t'i shqyrtojmë se cilat argumente janë të vërteta apo të pavërteta. Shprehja e Gettier u krijua, për të treguar këto raste, të cilat janë bërë paradigme në teorinë e njohjes së Gettier. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm probleme të mëtejshme, pasi ne tani vetëm duhet t'i shqyrtojmë se cilat argumente janë të vlefshme apo të vërteta.

METODOLOGJIA

Si metodë kryesore në këtë punim merret metoda analitike dhe leximi kritik i teksteve, librave të autorëve të ndryshëm që na shërbejnë si burim për të arritur deri tek konkluzionet dhe qasja kritike ndaj veprimtarisë filozofike të problemit të dijes në filozofi. Burimet e zgjedhura ofrojnë materialin për realizimin e punimit ku këto burime mund të jenë; libra, fjalor, revista të ndryshme. Qasja në punim të temës ofron një interpretim të disa natyrave sa i përket problematikave që mund t'i hasim në filozofinë e shumë autorëve të cilët u morrën me problemin e dijes në filozofi. Nga analiza e trajtuar nga librat e autorëve të ndryshëm të trajtuar në punim arrihet të dalin në përfundim zgjidhje të disa problematikave që i gjejmë në filozofi në lidhje me problemin e përkufizimit të dijes në filozofi. Për këtë arsye, teoria e njohjes dhe problemi i dijes zënë një hapësirë mjaft të gjerë në përpunimin e problemit të përkufizimit të dijes.